



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 1223 Prot.

Tiranë më 07.05.2024

REKOMANDIM

Nr.07, datë 07.05.2024

MBI

**RESPEKTIMIN E DETYRIMEVE LIGJORE NË KUADËR
TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE
PËR KONTROLLUESIT E ARSIMIT TË MESËM TË LARTË**

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31, pika 1 germa a/1, dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), në kuadër të mbikëqyrjes së aktivitetit të Kontrolluesve publik dhe privat në sektorin e arsimit të mesëm të lartë, (në vijim, “IA/Shkollat ose Kontrolluesit”) në përmbushje të respektimit të parimeve dhe detyrimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, me qëllim mbikëqyrjen dhe sensibilizimin e këtij sektori;

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Ligjit, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), ka realizuar hetime administrative për mbikëqyrjen e proceseve përpunuese nga Kontrolluesit publik dhe privat në sektorin e arsimit të mesëm të lartë, me qëllim verifikimin e respektimit të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji.

Zyra e Komisionerit gjatë veprimtarisë monitoruese, mbi zbatimin e detyrimeve të Ligjit nga Kontrolluesit, ka vërejtur disa problematika në lidhje me ligjshmërinë e përpunimit, sigurinë dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, nga kontrolluesit publik dhe privat në sektorin e arsimit të mesëm të lartë gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre, veçanërisht gjatë përdorimit të rrjeteve sociale dhe platformave teknologjike.

Monitorimi i proceseve përpunuese të të dhënave personale të kontrolluesve publik dhe privat në sektorin e arsimit të mesëm të lartë, nisur nga rëndësia e këtyre të dhënave, por edhe nga fakti se ka një numër shumë të lartë Kontrolluesish që operojnë në këtë sektor, të cilët përpunojnë të dhëna personale në sasi të mëdha, në përmbushje të detyrimeve ligjore sipas përcaktimeve të legjislacionit specifik, është në vëmendje të vazhdueshme

nga ana e Zyrës së Komisionerit. Gjithashtu, kujdes i posaçëm i kushtohet të dhënave personale të fëmijëve/nxënësve nën 18 vjeç (të mitur), për të shmangur pasojat e rënda që mund të vijnë për shkak të publikimit online të të dhënave të tyre si dhe nga aksesit ose përhapja e këtyre të dhënave nga persona të paautorizuar, në mënyrë të paligjshme.

Ndërkohë, krahas dispozitave të sipërpërmendura të Ligjit, hetimet administrative janë bazuar edhe në parashikimet e akteve nënligjore të tjera detyruese të nxjerra nga Zyra e Komisionerit në zbatim të Ligjit dhe më specifikisht të Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*) dhe Udhëzimit nr. 4, datë 16.03.2010 për *“Marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit”*, i ndryshuar, (në vijim, *“Udhëzimi nr. 4”*).

Gjatë inspektimeve të kryera pranë Kontrolluesve janë konstatuar disa mangësi në drejtim të respektimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, konkretisht, sigurisë së të dhënave, ligjshmërisë së përpunimit së të dhënave online dhe masave tekniko-organizative, siç parashikohet nga dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Në vijim disa nga problematikat e konstatuara gjatë hetimeve administrative të ushtruara pranë këtyre Kontrolluesve:

1. Kontrolluesit, ushtrojnë aktivitetin si institucione arsimore publike ose private, të nivelit të mesëm të lartë, në zbatim të ligjit nr. 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, Vendimit nr. 99, datë 27.2.2019 *“Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”*, si dhe Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020 të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë *“Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”*.

Në kuadër të veprimtarisë që kryejnë Kontrolluesit përpunojnë të dhëna personale për kategoritë, *“nxënës”*, *“mësues”*, *“prindër”*, *“punonjës”*, *“nëpunës”*, *“personeli ndihmës”*, *“staf akademik”*, *“vizitor”*, *“kujdestar ligjor”*, etj., në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Rezulton se, në shumë raste, Kontrolluesit nuk kanë parashikuar afate për ruajtjen e të dhënave personale që përpunohen (*p.sh., mësues të larguar*) në tejkalim të qëllimit të përpunimit, në kundërshtim me një nga parimet tek i cili bazohet mbrojtja e të dhënave personale, të parashikuar në germën *“d”*, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Gjithashtu, në ambientet e veçanta të shkollës, ku punonjësi i shërbimit psiko-social ushtron veprimtarinë, në kuadër të identifikimit dhe trajtimit të problematikave të ndryshme, sipas nevojave psiko-sociale të subjekteve të të dhënave, konstatohet se të dhënat sensitive të grumbulluara gjatë aktivitetit, ruhen pa afat, në kundërshtim me germën *“d”* të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Njëkohësisht, duke marrë në konsideratë natyrën sensitive të të dhënave që administrojnë konstatohet se, për ofrimin e shërbimit psiko-social nuk janë marrë masa të përshtatshme sigurie, me qëllim parandalimin e rreziqeve të tilla si aksesit i paautorizuar tek të dhënat, shkatërrimi, humbja, përdorimi, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesit duhet të parashikojnë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesit, në përputhje me parashikimin e gurmës “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesit duhet të realizojnë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesit për ofrimin e shërbimit psiko-social janë të detyruar të marrin masa sigurie (sipas nenit 27 Ligjit) për mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave (nxënës) që përpunohen, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të dhënave sensitive. Të dhënat sensitive duhet të ruhen të ndara nga çdo e dhënë tjetër personale e punonjësve, duke vendosur rregulla të posaçme të dedikuara mbrojtjes së të dhënave sensitive të punonjësve.

3. Konstatohet se, Kontrolluesit disponojnë llogari në platformën “Facebook” dhe “Instagram”, në të cilat pasqyrojnë aktivitete të zhvilluara, ndër të tjera, duke i ilustruar/publikuar online nëpërmjet fotografive dhe videove të nxënësve të shkollës, të marra gjatë aktiviteteve mësimore, kulturore, festa, etj.

Rezulton se në disa raste, Kontrolluesit nuk aplikojnë deklarata lidhur me dhënien e pëlqimit nga ana e prindërve/kujdestarit ligjor për nxënësit nën 18 vjeç, si dhe për vetë nxënësit mbi 18 vjeç, për publikimin e pamjeve fotografike dhe videove në rrjetet sociale, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, si dhe Udhëzimit nr. 4.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, publikimi i të dhënave personale të nxënësve (*fotografi dhe video*), në llogaritë e krijuara dhe të administruara në rrjetet sociale (*Facebook, Instagram, etj.*), pa siguruar pëlqimin paraprak të prindërve dhe/ose të kujdestarëve ligjor, nuk gjen mbështetje në asnjë parashikim ligjor konkret me qëllim që të konsiderohet i ligjshëm. Kontrolluesit kanë detyrimin që të përpunojnë të dhënat personale të subjekteve të të dhënave duke respektuar parimin e ligjshmërisë së

përpunimit dhe në përputhje me kriteret ligjore të përpunimit, parashikuar në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

“Pëlqimi”, është një nga 6 principet ligjore për përpunimin e të dhënave personale, i parashikuar në pikën 1, të nenit 6 të Ligjit. Në rastin kur Kontrolluesi fillon një përpunim të dhënash, ai duhet të konsiderojë se cila është baza e përshtatshme ligjore për vazhdimin e përpunimit. Nëse është marrë në përputhje me Ligjin, *“pëlqimi”* është një mjet që i mundëson subjektit të të dhënave, kontroll nëse të dhënat personale të tij do të përpunohen apo jo.

4. Konstatohet se, edhe në rastet kur I/A shkolla aplikon për nxënësit formularin e pëlqimit, në të cilin shprehet dakordësia për publikimin e fotografive të fëmijëve, nën 18 vjeç, si dhe për vetë nxënësit mbi 18 vjeç, rezulton se informimi nuk është i plotë. Informimi nga Kontrolluesi përkundrejt subjekteve të të dhënave nuk është shterues në lidhje me qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje) etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave është shumë i rëndësishëm, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbushja e këtij detyrimi nga Kontrolluesi mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Informimi sipas përcaktimeve të nenit 18 të Ligjit, duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, që kryen Kontrolluesi.

5. Kontrolluesit privat kanë lidhur kontratë/marrëveshje shërbimi me palë të treta për montimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të video-survejjimit (CCTV) që disponojnë, por nga verifikimi i kontratës/marrëveshjes, rezulton se, në përmbajtje të saj nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”* i ndryshuar (në vijim, *Udhëzimi nr. 19*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, palët duhet të miratojnë një kontratë tip, me anë të së cilës të garantojnë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien midis Kontrolluesit dhe Përpunuesit, kjo me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave tek përpunuesit, të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu, palët duhet të specifikojnë masa konkrete teknike-organizative të detyrueshme për tu zbatuar nga ana e Përpunuesit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

6. Rezulton se, Kontrolluesit disponojnë sistem video-survejimi CCTV, për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të tyre, për qëllim të sigurisë së personelit, nxënësve dhe pronës. Kontrolluesit në disa raste nuk disponojnë tabelë informimi për mbikëqyrjen e ambienteve me sistemin CCTV, dhe në ato raste që e disponojnë, tabela nuk është sipas modelit standard, në kundërshtim me parashikimin e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 3*”).

Gjithashtu, lidhur me këtë proces përpunues, Kontrolluesit nuk kanë miratuar rregulla/politika të brendshme specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video-survejimit CCTV, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit, si dhe Udhëzimi nr. 3.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

Sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 3, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video regjistrimi është në veprim, duke vendosur njoftimin e shkruar në hapësirën e monitoruar. Gjithashtu, Kontrolluesi detyrohet të vendosë në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejimit të miratuar nga Komisioneri.

7. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, si dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezulton se, disa Kontrollues nuk kanë përmbushur detyrimin për “*Njoftim*” në zbatim të nenit 21 të Ligjit, si dhe disa të tjerë, nuk kanë kryer përditësimin e njoftimit, për ndryshim të gjendjes së Njoftimit të përpunimit, të njoftuar më parë, sipas nenit 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, detyrimi për njoftim dhe përditësimi i “*Formularit të Njoftimit*” është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin e të dhënave që kryen Kontrolluesi dhe të ushtrojnë në mënyrë korrekte të drejtat që u jep ligji. Mospërmbushja e detyrimit për “*Njoftim*” përbën shkelje të neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

8. Rezulton se, Kontrolluesit për komunikimet me Zyrën Vendore Arsimore apo me personelin e shkollës, për qëllime të procesit të punës kanë krijuar adresë emaili në domain-e privat si “*gmail, yahoo, etj*”, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, komunikimi elektronik i të dhënave nëpërmjet adresave email nën domain-et private, rrezikon cenimin e të dhënave personale të cilat komunikohen midis palëve, pasi platformat teknologjike të tipit mail-server që përdoren, nuk janë në administrimin e vetë institucionit apo institucioneve shtetërore që ofrojnë këtë shërbim. Mos përdorimi i shërbimeve qeveritare TIK, në këtë rast të postës elektronike, të ngritura në rrjetin GovNet (shërbime qeveritare të standardizuara dhe të sigurta), cenon sigurinë dhe vazhdimësinë e informacionit të përpunuar nga punonjësit.

Rezulton se, Kontrolluesit nuk disponojnë rregullore *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, por dhe në ato raste që e disponojnë i referohen modelit *“tip”* të publikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit. Megjithatë, nga shqyrtimi i tyre konstatohet se, përmbajtja e tyre është e kufizuar dhe nuk reflekton detyrimet ligjore, sipas kategorive specifike të të dhënave personale që përpunon Kontrolluesi, kategorive të subjekteve të të dhënave në referim të parimeve ligjore dhe rregullave specifike të parashikuara në udhëzimet specifike të miratuara nga Komisioneri, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një rregulloreje specifike *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., por edhe akteve të tjera të brendshme të cilat parashikojnë masa teknike dhe organizative për procese të ndryshme përpunuese, konsiderohen shumë të rëndësishme në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

9. Kontrolluesit nuk kanë ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të Kreut IV të Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesit duhet të marrin masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim ndërgjegjësimitin e punonjësve të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

10. Në disa raste, Kontrolluesit nuk aplikojnë “*Deklaratë konfidencialiteti*” me punëmarrësit të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, qëllimi i nënshkrimit të “*Deklaratës së konfidencialitetit*”, është që të gjithë punonjësit të cilët kanë akses në të dhënat personale, të kuptojnë qartë dhe drejtë detyrimet që ata kanë mbi përpunimin e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit. Në aktin formal me titull “*Deklaratë konfidencialiteti*”, dalë në zbatim të Vendimit nr. 6 të Komisionerit, datë 05.08.2013 “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurinë e të dhënave personale*” (në vijim, “*Vendimi nr. 6*”), punëmarrësit informohen mbi përgjegjësitë në rast përhapje në mënyrë abuzive të të dhënave personale tek personat e paautorizuar.

Zyra e Komisionerit thekson se, nevojitet një angazhim serioz i Kontrolluesve publik dhe privat në sektorin e arsimit të mesëm të lartë, me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor për informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe garantimin dhe respektimin e të drejtave të tyre, në lidhje me marrjen e masave tekniko-organizative për sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, në përputhje me Ligjin dhe Udhëzimeve nr. 3, nr.4, nr.19, nr 47 të Komisionerit, si dhe Vendimit nr.6 të Komisionerit.

Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesve të këtij sektori është shumë i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 6, 18, 20, 21, 22, 27, 28, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesit, të kenë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kreun II të Ligjit;
2. Kontrolluesit, të marrin masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
3. Kontrolluesit, të marrin masa për aplikimin e deklaratave të pëlqimit me prindërit/kujdestarët ligjor ose me vetë nxënësit mbi 18 vjeç, në rastet e përpunimit/publikimit të të dhënave të nxënësve në rrjetet sociale;
4. Kontrolluesit që ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e arsimit të mesëm të lartë, të marrin masa për të fshirë të dhënat personale fotografi/video, të publikuara në rrjetet

sociale “Facebook”, “Instagram”, në të gjitha ato raste që nga ana e tyre nuk është garantuar marrja e pëlqimit nga prindërit e nxënësve/ përfaqësuesit ligjor, ose e vetë nxënësit mbi 18 vjeç;

5. Kontrolluesit, të marrin masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;
6. Kontrolluesit, të marrin masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit, duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit;
7. Në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të plotësohet detyrimi për njoftim nga Kontrolluesit, të cilët nuk e kanë zbatuar këtë detyrim për herë të parë, si dhe të tregohet kujdes në vijimësi, në përditësimin e njoftimit për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të njoftuar më parë;
8. Kontrolluesit, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të marrin masa për të hartuar rregullore specifike “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
9. Kontrolluesit, të marrin masa për garantimin e sigurisë së informacionit të përpunuar nga punonjësit, duke shmangur përdorimin e adresave elektronike personale të krijuara në domaine private, duke i zëvendësuar me shërbimet qeveritare TIK të standardizuara dhe të sigurta;
10. Kontrolluesit, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të marrin masa të aplikojnë “*Deklaratën e konfidencialitetit*” me punëmarrësit të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale;
11. Kontrolluesit, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale;
12. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për organizimin e punës për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të marrë masa që në bashkëpunim me strukturat e saj të varësisë të zbatojnë të gjithë detyrimet që rrjedhin nga Ligji;
13. Ministria e Arsimit dhe Sportit, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimtarisë së përgjithshme të institucioneve arsimore, duhet të marrë masa për të adresuar drejt të gjithë Kontrolluesve, detyrimet rekomanduese të dala nga ky akt i

Komisionerit, brenda afatit kohor 90 (nëntëdhjetë) ditë, duke filluar nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

14. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 07.05.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi